

# PASQYRË BURSASH

PËR NXËNËS, STUDENTË DHE EKSPERTË  
TË ARDHSHËM NGA KOSOVA



Ambasada  
e Republikës Federale të Gjermanisë  
Prishtinë



# Përmbajtja

<b>Parathënie</b>	4
1. Bursa për nxënës	5
1.1 Europeans for peace	6
<b>2. Bursat për studentë dhe shkencëtarë</b>	7
2.1 DAAD	8
2.2 Bursat kërkimore të Fondacionit Alexander von Humboldt	9
2.3 Erasmus Mundus – Kurse Masters dhe programe doktorate	10
2.4 Bursat „Studienkolleg zu Berlin“	12
2.5 Bursat e Fondacionit Friedrich Ebert	14
2.6 Bursat e Fondacionit Friedrich Nauman për Lirinë	16
2.7 Bursat e Fondacionit Konrad Adenauer	17
2.8 Bursat e Fondacionit Rosa Luxemburg për studentë dhe doktorantë	19
2.9 Travel to Europe	21
<b>3. Bursa për ekspertë të ardhshëm</b>	22
3.1 Bursat Ndërkombëtare të Parlamentit (IPS)	23
3.2 Bursat e Ekonomisë Gjermane	24
3.3 Bursat e Fondacionit Fritz dhe Helga Exner	25
3.4 Bursa studimi në Gjermani për disiplina të ndyshme sportive	26
3.5 Bursat e Fondacionit Alexander Rave për kuratorë, restaurues, teknikë të muzeve dhe menaxherë të kulturës	27
<b>4. Mundësi për mësimdhënës të gjuhës gjermane</b>	28
4.1 Seminare për mësimdhënës të gjuhës gjermane	29

## Parathënie



Pas vetëm një viti Ambasada Gjermane në Prishtinë sjell botimin e dytë të broshurës së saj rreth mundësive për marrjen e bursave. Për këtë na kanë përkrahur shumë fondacione dhe organizata gjermane. Broshura jonë ka zgjuar interesim të madh tek grupi i synuar. Për këtë sukses flet fakti që në një kohë të shkurtër janë marrë të gjitha eksemplarët e përgatitura, si dhe numri i madh i vizitorëve në rubrikën përkatëse të faqës sonë të internetit, ku mund të shikohet dhe shkarkohet kjo broshurë.

Për Ambasadën Gjermane në Prishtinë ky është një konfirmim dhe një stimulim. Edhe me botimin e dytë ne dëshirojme të ofrojmë një pasqyrë të programeve të ndryshme për nxënës, studentë dhe ekspertë të ardhshëm nga Kosova. Ky është një mjet i dobishëm për të rinjtë dhe të rriturit, të cilët janë të interesuar të studiojnë në Gjermani, të shkollohen më tutje apo të marrin pjesë në shkëmbime shkencore dhe shoqëro-politike. Ajo është një shtytje për t'u interesuar për Gjermaninë dhe jetën në Gjermani, pasi njohja me kultura tjera edhe më tej është rruga më e mirë që njeriu të njihet më mirë edhe me vetveten dhe kulturën e tij.

Në mënyrë që broshura të ketë formë doracaku, në të nuk kanë mundur të përfshihen të gjitha detajet e çdo programi. Mirëpo ajo përmban adresat kontaktuese të programeve përkatëse, ku mund të gjeni informata më të hollësishme mbi bursat e caktuara. Edhe në faqën tonë të internetit ju gjithashtu mund të gjeni informata mbi temat e shkëmbimit akademik dhe studimeve në Gjermani.

Ju dëshiroj edhe më tej fat gjatë konkurimit!

### **Dr. Ernst Reichel**

*Ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë*

# **1. Bursa për nxënës**



## 1.1 EUROPEANS FOR PEACE

**EUROPEANS FOR PEACE** përkrah projekte ndërkombëtare në kuadër të partneriteteve në mes të shkollave dhe/apo institucioneve jo-arsimore. Kjo bursë i drejtohet të rinjve të moshës 14 - 21 vjeç nga Gjermania, vendet e Evropës së Mesme, Lindore dhe asaj Jugore si dhe nga Israeli.

Në qendër të punës së projektit qëndrojnë tematikat e historisë evropiane të shekullit 20 si dhe sfidat aktuale të ruajtjes së paqes, demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Programi shpallet çdo vit me një temë të re.

EUROPEANS FOR PEACE është një program i Fondacionit "Erinnerung, Verantwortung und Zukunft" („Kujtimi, përgjegjësia dhe e ardhmja“). Nga viti 2005 janë vënë në dispozicion 4,3 milionë € për 330 projekte.

### **Kur është afati i fundit për aplikim?**

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve të projekteve në gjuhën gjermane dhe atë angleze është 15 janari i çdo viti.

### **Informata apo kontakti?**

*Personi kontaktues:*

*Heide Luebge*

*[luebge@stiftung-evz.de](mailto:luebge@stiftung-evz.de)*

Informata më të hollshme mbi temat e shpallura, ide të shumëta për projekte si dhe dokumentet e aplikimit i gjeni në [www.europeans-for-peace.de](http://www.europeans-for-peace.de)

## **2. Bursat për studentë dhe shkencëtarë**

## 2.1 Bursat e DAAD-së

DAAD (Shërbimi Gjerman për Shkëmbim Akademik) ofron bursa për studentë dhe shkencëtarë kosovarë për çdo viti akademik.

### Kushti kryesor?

Të gjithë kandidatët duhet të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës gjermane ose asaj angleze.

### Llojet e bursave?

Për studentë të të gjitha drejtimeve para përfundimit të studimeve Bachelor:

- Bursa për vijim të kurseve verore në fakultete për studentë të avancuar dhe udhëtime studimore
- Bursa për vijim të kurseve intensive gjuhësore në Gjermani (këto kurse nuk janë për studentë të degëve të gjuhës gjermane)

Për të diplomuar të studimeve Bachelor

- Bursa studimi për kryerjen e studimeve Master në një shkollë të lartë gjermane (universitet gjerman) për të gjitha drejtimet shkencore dhe artistike

• Bursa studimi DAAD/OSI (Open Society Institute) për studime Master apo synime promovimi në drejtimet: shkenca humanitare, shkenca shoqërore dhe sociologji

Për doktorantë, shkencëtarë (të rinj) dhe profesorë të fakulteteve

- Bursa për kurse në shkolla/universitete verore
- Bursa për kurse në shkolla/universitete verore
- Bursa për kurse në shkolla/universitete verore

Për doktorantë, shkencëtarë (të rinj) dhe profesorë të fakulteteve

Për doktorantë dhe shkencëtarë të rinj

- Bursa afatshkurtëra për hulumtime (1-6 muaj)

- Bursa hulumtimi (7-12 muaj)

Për mësimdhënës të shkollimit të lartë, shkencëtarë (në një shkollë të lartë apo institut shkencor)

- Qëndrime kërkimore (1-3 muaj)

### Afati i fundit për aplikim?

Afati i fundit për aplikim është tetori i çdo viti. Për këtë drejtohuni tek zyra ndërlidhëse e DAAD-së në Universitetin e Prishtinës.

### Kontakti apo informata shtesë?

Për informata më të hollësishme vizito faqen e internetit:

<http://www.daad.de>

### Informatat në Zyrën ndërlidhëse të DAAD-së në Universitetin e Prishtinës:

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, Prishtinë

Tel: +381-38-222-970

E-mail: [daad\\_prishtina@yahoo.de](mailto:daad_prishtina@yahoo.de)

Dokumentet e kompletuara për aplikim duhet të dorëzohen personalisht në Ambasadën Gjermane në Prishtinë, në adresën:

Ambasada Gjermane

Seksioni për Kulturë

Rruga Azem Jashanica 17

Arbëria II

Prishtinë

E-Mail: [info@pris.auswaertiges-amt.de](mailto:info@pris.auswaertiges-amt.de)





**Alexander von Humboldt**  
Stiftung/Foundation

## 2.2 Bursat kërkimore të Fondacionit Alexander von Humboldt për doktorantë dhe shkencëtarë me përvojë

Fondacioni Alexander von Humboldt me Bursën Kërkimore Humboldt i mundëson shkencëtarëve jashtëzakonisht të talentuar nga vendet e huaja një bursë kërkimore për një qëndrim më të gjatë kërkimor në Gjermani. Aplikuesi zgjedh vetë temën e kërkimit dhe mentorin e tij në një institucion shkencor. Për vendet apo disiplinat e caktuara nuk ka numër të caktuar.

### **Cilat janë kushtet?**

Shkencëtarët të cilët kanë mbaruar studimet e doktoratës më së largu para 4 viteve mund të aplikojnë për Bursën Kërkimore Humboldt për postdoktorantët.

Kurse shkencëtarët, të cilët kanë mbaruar studimet e doktoratës më së largu para 12 viteve mund të aplikojnë për Bursën Kërkimore Humboldt për shkencëtarë me përvojë.

### **Çfarë ofron bursa?**

Për shkencëtarët e rinj bursa zgjatë nga 6 deri 24 muaj dhe ka vlerë prej 2.250 Euro në muaj. Kurse për shkencëtarët me përvojë bursa zgjatë 6 deri 18 muaj (që mund të ndahen në 3 qëndrime) me ka vlerë prej 2.450 Euro në muaj.

Përveç pagesës mujore bursa gjithashtu përfshinë edhe një mesatare të shpenzimeve të udhëtimit, shtesa familjare, një kurs të gjuhës, sipas nevojës një „Shtesë evropiane“ e cila shërben për qëndrime kërkimore afatshkurtëra në shtetet tjera evropiane në kuadër të bursës, si dhe një përkrahje të gjërë të të gjithë ishburstitëve.

Gjithashtu është e mundur të kërkohet një bursë e kthimit.

### **Kur është afati i fundit për aplikim?**

Aplikacionet mund të dorëzohen në çdo kohë.

### **Informata shtesë dhe kontakti?**

Informata shtesë mund të gjeni në: [www.humboldt-foundation.de/web/programme.html](http://www.humboldt-foundation.de/web/programme.html)

Kontakt: [info@avh.de](mailto:info@avh.de)



## 2.3 Erasmus Mundus - Kurse Master dhe Programe Doktorate

Erasmus Mundus ofron bursa për studentë dhe hulumtues jashtëzakonisht të talentuar për të marrë pjesë në një kurs Master të Erasmus Mundus ose në një program të përbashkët doktorate – Ph.D. (Action 1) në dy apo më shumë universitete evropiane. Këtu ofrohet mundësia e zgjedhjes në mes 131 programeve Master dhe 34 programeve doktorate.

Gjithashtu Erasmus Mundus ofron bursa për studentë dhe akademikë në kuadër të një partneriteti në mes të universiteteve kosovare dhe evropiane (Action 2). Koha e këtyre vizitave studimore mund të zgjasë nga 3 muaj deri në 3 vite.

Mundësitë në kuadër të Partneriteteve Erasmus Mundus

Çdo vit janë duke u krijuar më shumë partneritete bashkëpunimi në mes të universiteteve të BE-së dhe shteteve të Ballkanit perëndimor – duke përfshirë Kosovën. Në faqen e internetit do të gjeni informata rreth asaj, se cilat partneritete janë lidhur për cilat disiplina dhe në mes të cilave universiteteve.

Kjo vlenë për të gjitha nivelet e studimeve: Bachelor, Master, doktoratë dhe postdoktoratë. Gjithashtu ofrohen bursa për punonjës të universiteteve.

### **Cilat janë kushtet?**

Për më shumë informata rreth bursave për kandidatët nga Kosova vizitoni faqen e internetit: [http://eacea.ec.europa.eu/erasmus\\_mundus/results\\_compendia/selected\\_projects\\_action\\_2\\_en.php](http://eacea.ec.europa.eu/erasmus_mundus/results_compendia/selected_projects_action_2_en.php)

### **Çfarë ofron bursa?**

Bursat janë bursa të plota dhe mbulojnë pagesat semestrale, pagesën e jetesës dhe udhëtimin për në Evropë. Shuma e bursës ndryshon, në varësi të nivelit të studimeve, kohëzgjatjes së studimit (nga 3 muaj deri në 3 vite) dhe kombësisë.

Për aplikuesit nga Kosova vlejné këto shuma:

24 000 € për çdo vit për një program Master (Action 1)

60 000 € deri 130 000 € për programin trevjeçar Joint Doctorates-Promotionsprogramm (Action 1)

13 750 € për një qëndrim gjashtë deri dhjetë mujor si undergraduate/bachelor (Action 2), deri 65 000 € për doktoratë në kohëzgjatje prej tri vjetësh.

### **Kur është afati i fundit për aplikim?**

Pasi të keni zgjedhur një program duhet të vazhdoni në faqen e internetit të atij kursi, ku do të gjeni informata të detajuara mbi pagesat, kriteret që duhet plotësuar etj. Për programet e çdo viti akademik mund të aplikoni nga shtatori. Afati i fundit mund të ndryshojë.

### **Më shumë informata?**

Ju lutem dërgoni aplikacionet drejtpërdrejt kordinatorit të programit që keni zgjedhur! Informata shtesë:

Erasmus Mundus: [http://eacea.ec.europa.eu/erasmus\\_mundus](http://eacea.ec.europa.eu/erasmus_mundus)

Zyrja e informimit në Kosovë:

[http://eacea.ec.europa.eu/tempus/tools/contacts\\_national\\_tempus\\_offices\\_en.php#Koso](http://eacea.ec.europa.eu/tempus/tools/contacts_national_tempus_offices_en.php#Koso)

Emrat dhe faqet e internetit të tre partnerëve për Ballkanin perëndimor:

EUROWEB <http://www.mrtc.mdh.se/euroweb>

JoinEU-SEE III <http://www.joineusee.eu>

ERAWEB [www.erasmus-westernbalkans.eu](http://www.erasmus-westernbalkans.eu)



## 2.4 Bursat „Studienkolleg zu Berlin“

„Studienkolleg zu Berlin“ u dedikohet studentëve jashtëzakonisht të talentuar të të gjitha drejtimeve të studimit në tërë Evropën, të cilët janë të gatshëm të regjistrohen për një vit në një universitet të Berlinit ose Brandenburgut. „Studienkolleg zu Berlin“ ofron çdo vit rreth 30 vende studimi. Nga këto vende 20 i dedikohen studentëve nga Evropa dhe së paku 10 vende bursistëve gjermanë të këtij fondacioni.

### **Cilat janë kushtet?**

- Studime shkencore në shkollimin e lartë (të gjitha drejtimit)
- Studimet themelore të përfunduara (ose së paku katër semestra të një drejtimi)
- Mosha maksimale 28 vjeç
- Të arritura të shkëlqyeshme në studime
- Interesim të madh në çështjet evropiane
- Aftësi për të punuar në grup, si dhe gatishmëri për punë intensive në projekt
- Angazhim në çështjet shoqërore
- Të gjithë kandidatët në mënyrë të pavarur duhet të gjejnë një vend studimi në Berlin apo Brandenburg.

### **Nga kandidatët e huaj kërkohet gjithashtu:**

- Nënshpëtimet e ndonjë shteti të BE-së (por ka mundësi të bëhen përjashtime edhe për shtetet e tjera evropiane)
- Njohuri të mira të gjuhës gjermane, si dhe të ndonjë gjuhe tjetër evropiane në të shkruar dhe në të folur
- Aplikimi bëhet pas propozimit nga një partner i Fondacionit me seli në Gjermani apo jashtë Gjermanisë, si dhe
- Rekomandim (në formë raporti) nga një shkencëtar me përvojë.

### **Çfarë ofron bursa?**

„Studienkolleg zu Berlin“ përbëhet nga një program dhe një bursë.

Programi përfshinë:

- seminar njëjavor në fillim
- punë projekti në grupe të vogla për një temë të integritimit evropian
- organizime të rregullta në mbrëmje (ligjerata dhe diskutime) si dhe seminare në fundjavë
- seminar (dy ditë e gjysëm) të retorikës
- kurs të gjuhës gjermane për studentët e interesuar

**Bursa përfshinë:**

- bursë mujore në vlerë prej 600 €
- një shumë të hollash në vlerë prej 400 € si përkrahje për punën në një projekt (apo për udhëtim eventual për arsye të punës në projekte)
- një shumë të hollash në vlerë prej 1000 € për mobilitet (bilta udhëtimi),
- shpenzimet e programit dhe të administratës për kolegji merren përsipër nga dy fondacionet themeluese
- gjatë vitit, si pjesë e këtij programi, fitohet statusi „Bursist“ në të dyja Fondacionet me çasje në të gjitha ofertat. Më pas fitohet statusi „Alumni“ (ish-bursist).

**Kur është afati i fundit për aplikim?**

Programi fillon me semestrin dimëror dhe mbaron me semestrin pasues veror.

**Më shumë informata?**

Këto si dhe informata të tjera mund t'i gjeni në faqen e internetit:

[www.studienkolleg-zu-berlin.de](http://www.studienkolleg-zu-berlin.de)



## 2.5 Bursat e Fondacionit Friedrich Ebert për studentë të huaj

Fondacioni Friedrich Ebert është një fondacion politik, i cili u referohet të drejtave themelore të demokracisë sociale. Prandaj ky fondacion punon për mundësimin e drejtë të çasjes në arsimim. Që më se 85 vite ai ndihmon studentët dhe të diplomuarit e talentuar dhe të angazhuar politikisht, të cilët janë të gatshëm që me aftësitë e tyre të kontribuojnë në shoqëri.

### Cilat janë kushtet?

Kandidatët e huaj mund të përfitojnë nga kjo bursë vetëm atëherë nëse në kohën e aplikimit ata janë duke studiuar në Gjermani dhe mund të dëshmojnë rezultatet e para të studimeve. Njohja e gjuhës gjermane është kusht dhe duhet të dëshmohet. Kjo vlenë edhe nëse Masteri kryhet në gjuhën angleze.

### Çfarë ofron bursa?

Bursistët do të jenë pjesë e një rrjeti të madh të bursistëve aktual dhe të mëhershëm të fondacionit Friedrich Ebert.

Gjatë studimeve studentët do të kenë kujdestarë personal brenda fondacionit si dhe mentorë nga rrethi i bursistëve të mëhershëm.

Fondacionit Friedrich Ebert gjithashtu përkrah angazhimin politik-shoqëror si dhe kompetencat sociale të bursistëve me një program arsimor të gjerë.

Për të huajit ofrohen këto dy programe:

### Përkrahja për studentë

(shih <http://www.fes.de/stufo/stipendien/stipendienprogramme/die-globale-community>)

Fondacioni Friedrich Ebert përkrah studentët e të gjitha drejtimeve në shkollat e larta, shkollat profesionale si dhe në studimet Master (duhet të jenë institucione shtetërore apo të akredituara nga shteti). Ai nuk përkrah fazat e përfundimit të studimeve e as qëndrime studimore jashtë Gjermanisë.

### Çfarë ofron bursa?

Bursa për studentë momentalisht është 650 euro në muaj.

### Kur është afati i fundit për aplikim?

Aplikacionet mund të dorëzohen në çdo kohë, por për kategoritë e caktuara vlenë:

- Për Bachelor: deri në fund të semestrit të tretë.
- Për provim shtetëror / diplomë Master: deri në fund të semestrit të gjashtë.
- Për program Master / studime pasuniversitare: deri në fund të semestrit të parë.

### **Përkrahja për doktorantë**

(shih <http://www.fes.de/stufo/stipendien/stipendienprogramme/weite-perspektiven>)

Fondacioni Friedrich Ebert përkrah doktorantët, të cilët janë pranuar për doktoraturë në një shkollë të lartë gjermane shtetërore apo të akredituar nga shteti i Gjermanisë.

Koha e bursës zakonisht zgjatë dy vite (më së shumti tri vite). Fondacioni nuk përkrah qëndrime studimore jashtë Gjermanisë e as doktoraturë apo trajnime/seminare në lëminë e mjekësisë.

### **Çfarë ofron bursa?**

Bursa për doktorantë momentalisht është 1.000 euro.

### **Kontakti?**

Friedrich-Ebert-Stiftung

Studienförderung

Godesberger Allee 149

D-53175 Bonn

Tel.: +49-228 883-0

Fax: +49-228 883-9225

[stipendien@fes.de](mailto:stipendien@fes.de)

[www.fes.de/studienfoerderung](http://www.fes.de/studienfoerderung)

## 2.6 Bursa e Fondacionit Friedrich Naumann për Lirinë

Fondacioni Friedrich Naumann për Lirinë që nga viti 2000 vepron në Kosovë. Ai punon në fusha të ndryshme si këshillim politik, shkollim dhe trajnim politik për pozitë udhëheqëse, përkrah dhe përcjell transformimin e Kosovës në fushat, si demokraci, sundim të ligjit dhe të ekonomi të tregut. Fondacioni gjithashtu forcon procesin e pajtimit duke u përqëndruar ndër të tjera në parandalimin e konflikteve.

Me masat e tij në fushën e arsimit fondacioni synon një zhvillim paqësor, një shoqëri të hapur civile dhe tolerancë ndaj pakicave. Fondacioni Friedrich Naumann përmes ofertave të tij arsimore si seminare, konferenca, punëtori dhe udhëtime studimore apo informative lobon për kuptimin e parimeve të Bashkësisë Evropiane, përgjegjësisë së partive, të parlamentit dhe shtetit ligjor, si dhe etablimentit të qëndrueshëm të mediave të pavarura.

### **Cilat janë kushtet?**

Në qendër të vëmendjes së përkrahjes së studentëve të talentuar nga Fondacioni Friedrich Naumann për Lirinë qëndron qëllimi i përcjelljes së vlerave themelore liberale dhe kualifikimeve bazë tek të rinjtë e talentuar. Nga aplikuesit kërkohet të kenë aftësi akademike, pra të kenë nota të mira ose shumë të mira gjatë studimeve, t'i jetojnë dhe përfaqësojnë vlerat liberale, si dhe të jenë të angazhuar në çështje politiko-shoqërore. Pas tjerash konkuresit duhet të kenë njohuri të gjuhës gjermane.

Fondacioni Friedrich Naumann për Lirinë përkrahë studentët e huaj, si dhe doktorantët e të gjitha fushave të studimit, të cilët janë të regjistruar në një shkollë të lartë gjermane. Studentët e huaj mund të konkurojnë pas mbarimit të studimeve Bachelor ndërsa doktorantët në fillim të marrjes së doktoratës së tyre.

### **Çfarë ofron bursa?**

Bursa ofron një përkrahje të gjerë ideore dhe nëpërmjet kësaj nxit angazhimin liberal si dhe zhvillimin e personalitetit të bursistëve. Bursat nuk duhet të kthehen. Për kohëzgjatjen e financimit të studimeve merret parasysh kohëzgjatja e rregullt e studimeve; doktorantët përkrahen më së shumti tri vite.

### **Afati i fundit për aplikim?**

Afati i fundit për aplikim është 31 maji dhe 30 nëntori i çdo viti.

### **Informata shtesë?**

<http://www.stipendium.freiheit.org>





## 2.7 Bursat e Fondacionit Konrad Adenauer

Ministria Federale për Punë të Jashtme e Gjermanisë i ndanë mjete Fondacionit Konrad Adenauer për mbështetje të studentëve të huaj që aktualisht studiojnë apo kanë diplomuar. Edhe studentët nga Kosova mund të aplikojnë për këtë përkrahje financiare dhe ideore të këtij fondacioni. Nga bursisët pritet që më pas të kontribuojnë në vendin e tyre duke vepruar si multiplikatorë në shkencë dhe kulturë, administrim dhe politikë dhe kështu të kontribuojnë në formimin e rrjeteve të qëndrueshme të elitave gjermane dhe të huaja.

Kjo bursë u dedikohet për shtetas të huaj, të cilët studiojnë apo kryejnë studimet e doktoratës dhe dëshirojnë të marrin një gradë akademike në një institucion të lartë shkencor, apo artistik (por jo në institucione të larta profesionale) në Gjermani, ose për ata, të cilët në kuadër të doktoratës në shtetin e tyre, dëshirojnë të bëjnë një udhëtim kërkimor me kohëzgjatje minimale njëvjeçare në Gjermani.

### Cilat janë kushtet?

- Kandidatët duhet të kenë arritur rezultate mesatare jashtëzakonisht të larta gjatë shkollimit të mesëm si dhe gjatë studimeve
- Ata duhet të jenë të angazhuar në sferën politike apo shoqërore
- Për studime në shkolla të larta të muzikës apo të artit në Gjermani kërkohet gjithashtu një dëshmi mbi kalimin e provimit pranues
- Nuk mund të përkrahen trajnime të specializimit për mjekësi dentare apo humane
- Kandidatët, të cilët në kohën e aplikimit e kanë arritur moshën 30 vjeçare nuk mund të aplikojnë
- Për aplikime në Gjermani duhet të dëshmohet njohja e gjuhës gjermane në nivelin DSH

### Çfarë ofron bursa?

- Studentët dhe doktorantët beçarë tani për tani marrin 750 € ose 950 € në muaj
- Ata gjithashtu marrin shtesa për sigurim shëndetësor dhe atë të përkujdesjes
- Nëse kandidatët janë në lidhje martesore apo kanë fëmijë ata gjithashtu përfitojnë shtesa të veçanta

### Kur është afati i fundit për aplikim?

Në Gjermani afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit me shkrim është 31 korriku. Intervistat bëhen në fund të tetorit të çdo viti.

### Kontakti?

Konrad-Adenauer-Stiftung  
HA Begabtenförderung Kultur  
Abteilung Ausländerförderung  
Dr. h.c. Berthold Gees  
Rathausallee 12

53757 Sankt Augustin  
Deutschland  
Tel. 02241-246-2307  
Fax 02241-246-2573  
Berthold.Gees@kas.de



## Bursat e Fondacionit Konrad Adenauer për studentët e Universitetit të Prishtinës

Fondacioni Konrad Adenauer është një ndër fondacionet më të mëdha politike në Evropë dhe botë i përfaqësuar në rreth 100 vende te botës. Fondacioni Konrad Adenauer çdo vit ofron bursa për studentët e Universitetit të Prishtinës.

### Cilat janë kushtet?

- Të jeni në vitin e tretë të studimeve të rregullta
- Të keni notën mesatare mbi 8.0
- Të njihni gjuhën angleze ose gjermane në të folur dhe në të shkruar
- Të jeni aktiv në ndonjë organizatë politike apo shoqërore (psh. parti apo OJQ) e cila është në përputhje me vetë idealet e Fondacionit Konrad Adenauer
- Të mos jeni përfutues i ndonjë burse tjetër, e as të jeni i punësuar (Fondacioni Konrad Adenauer posedon listat e të gjithë studentëve të cilët marrin ndonjë lloj burse shtetërore, komunale ose private për gjithë Kosovën)

### Çfarë ofron bursa?

- Bursë mujore në vlerë prej 100 € në muaj për një vit rresht (12 muaj x 100 €), duke filluar nga nënshkrimi i kontratës.
- Në kuader të bursës njëvjeçare bëjnë pjesë edhe disa trajnime politike apo sociale që organizohen për aftësimin e bursistëve të këtij fondacioni në lëmi të ndryshme.

### Kur është afati i fundit për aplikim?

Afati për aplikim në Fondacionin Konrad Adenauer fillon në janar të çdo viti dhe përfundon në fund të marsit.

Për më shumë informata kontaktoni Fondacionin në Prishtinë.

### Informata shitesë apo kontakti?

Fondacioni Konrad Adenauer  
Bulevardi Nëna Terezë nr. 46/5  
10000 Prishtinë  
Tel.: 038 229 874  
www.kas.de  
kas.kosovo@yahoo.de

## ROSA LUXEMBURG STIFTUNG

### 2.8 Bursat e Fondacionit Rosa Luxemburg për studentë

Me mjete nga Ministria Federale për Punë të Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë, fondacioni Rosa Luxemburg përkrah studentët, të cilët dëshirojnë të studiojnë apo të kryejnë studimet e doktoratës në Gjermani dhe synojnë të kthehen pas studimeve në Kosovë.

#### **Cilat janë kushtet?**

- Fletëregjistrimi (ose të paktën një dëshmi mbi pranimin) në një universitet shtetëror, ose të akredituar në Gjermani
- Dëshmi mbi përfundimin e studimeve Bachelor, ose studimeve themelore (diploma, magjistatura)
- Notë mesatare të shkëlqyeshme
- Njohuri shumë të mira të gjuhës gjermane (dëshmi mbi këto njohuri) – Nuk financohen kurse të gjuhës gjermane!

#### **Çfarë ofron bursa?**

- Bursë financiare, e cila tani për tani është 650 € në muaj
- Shtesa prej 20 € në muaj
- Në rast se duhet bërë një sigurim shëndetësor në Gjermani, Fondacioni paguan një shtesë në vlerë prej 50 € në muaj për këtë
- Në rast se keni fëmijë, të cilët jetojnë me ju, atëherë Fondacioni mund të paguaj shtesa për fëmijë, në vlerë prej 154 € në muaj

#### **Kur është afati i fundit për aplikim?**

Për bursë nga 1 prilli i vitit të ardhshëm, afati i fundit për aplikim është 31 tetori i vitit para-  
prak.

Për bursë nga 1 tetori, afati i fundit për aplikim është 30 prilli i të njëjtit vit.

#### **Informata më të hollësishme apo kontakti?**

[www.rosalux.de](http://www.rosalux.de)

## ROSA LUXEMBURG STIFTUNG

### Bursat e Fondacionit Rosa Luxemburg për doktorantë

#### Cilat janë kushtet?

- Fletëregjistrimi në një universitet shtetëror ose të akredituar në Gjermani apo në botën e jashtme
- Mbikçyrja nga një mentori në një universitet në Gjermani
- Përfundimi i studimeve me notë mesatare shumë të lartë.
- Angazhim në shoqërinë civile, në bazë të frymes së Fondacionit Rosa Luxemburg
- Njohuri shumë të mira të gjuhës gjermane (Dëshmi mbi këto njohuri) – Nuk financojmë kurse të gjuhës gjermane!
- Kandidatët nuk duhet të jenë më të vjetër se 30 vjeç

#### Çfarë ofron bursa?

Kohëzgjatja e bursës së ofruar është më së shumti dy vite. Bursa ngërthen:

- Bursën financiare, e cila tani për tani është 1000 € në muaj
- Shtesa prej 20 € në muaj
- Në rast se keni fëmijë, të cilët jetojnë me ju, atëherë fondacioni mund të Ju paguaj shtesa për fëmijë në vlerë prej 154 € në muaj

#### Kur është afati i fundit për aplikim?

Për bursë nga 1 prilli i vitit të ardhshëm, afati i fundit për aplikim është 31 tetori i vitit para-prak.

Për bursë nga 1 tetori, afati i fundit për aplikim është 30 prilli i të njëjtit vit.

#### Informata apo kontakti?

[www.rosalux.de](http://www.rosalux.de)

## 2.9 TRAVEL-TO-EUROPE - Bursë udhëtimi për studentë

Programi u drejtohet studentëve jashtëzakonisht të talentuar (nuk kërkohet ndonjë drejtim i caktuar) më njohuri të mira të gjuhëve të huaja (para se gjithash të gjuhës angleze).

### **Cilat janë kushtet?**

Përzgjedhja bëhet nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë  
Çfarë ofron bursa?

Projekti zgjatë rreth 4 javë, duke mos përfshirë kohën para dhe pas përgatitjes së projektit. Projekti fillon zakonisht në mesin apo fundin e muajit korrik dhe përfundon në mesin apo fundin e muajit gusht. Bursa mbulon shpenzimet e vizës (Ambasada Gjermane në Prishtinë i ofron ato pa pagesë), sigurimin shëndetësor të udhëtimit, bileta Interrail, para xhepi, para-dhe paspërgatitje, pjesëmarrje në organizimin e parë (me pjesëmarrës nga pesë vende të tjera të Ballkanit Perëndimor) në Berlin.

### **Afati i fundit për aplikim?**

Zakonisht afati i fundit për aplikim është në fund të qershorit. Data e saktë kumtohet dhe caktohet çdo vit nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë.

### **Kontakti në Kosovë?**

Raba Gjoshi, Drejtoreshë ekzekutive  
Besart Lumini, Koordinator i programit  
Youth Initiative for Human Rights  
Rr. Perandori Dioklecian 14, Kati i parë, 10 000 Prishtinë, Kosovë  
Tel/ Fax +381 38 248 509; Mob: +377 44 172 522

Paul-Georg Friedrich  
Drejtor i projektit  
Zyra Berlin  
Robert Bosch Stiftung GmbH  
Büro Berlin  
Bismarckstr. 71

### **3. Bursat për ekspertë të ardhshëm**

**IPS**Internationales Parlaments-Stipendium  
des Deutschen Bundestages

### 3.1 Bursa Ndërkombëtare e Parlamentit (IPS)

IPS u dedikohet talentëve të rinj, të cilët në vendin e tyre në mënyrë aktive dëshirojnë të angazhohen për arritjen e vlerave themelore demokratike. Bundestagu gjerman u jep të rinjve mundësinë që në kuadër të një angazhimi prej 15 javësh, përkrah një deputeti të Bundestagut gjerman të njihen me sistemin parlamentar gjerman dhe proceset politike vendim-marrëse, si dhe të mbledhin përvojë praktike në fushën e punës parlamentare. Qëllim i këtij programi është të përkrahen dhe forcohen lidhjet e Gjermanisë me shtetet pjesëmarrëse. Tani mund të aplikojnë të rinjë nga 28 shtete: Armenia, Azerbajxhani, Bellorusia, Bosnje dhe Herzegovina, Bullgaria, Estonia, Franca, Gjeorgjia, Hungaria, Izraeli, Kazakistani, Kosova, Kroacia, Letonia, Lituania, Mali i Zi, Maqedonia, Moldavia, Polonia, Republika Çeke, Rumania, Rusia, Serbia, SHBA, Shqipëria, Sllovakia, Sllovenia, Ukraina.

#### Cilat janë kushtet?

- Kandidatët duhet të kenë nënshtetësi kosovare
- duhet t'i kenë përfunduar studimet universitare, (të posedojnë diplomë në gradën B.A., B.S., Master/Magjistraturë, të kenë dhënë provimin shtetëror ose të kenë marrë doktoratën). Përfundimi i një shkolle të lartë profesionale nuk mjafton. (vërtetimi mbi përfundimin e studimeve mund të dorëzohet edhe deri më 31 dhjetor)
- duhet të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës gjermane
- profesioni që synohet: punësimi në detyrë shtetërore ose ndonjë punë tjetër publike në vendin tuaj, si p.sh. media, parti të ndryshme, shoqata, shkolla të larta etj.
- duhet të jenë më të ri se 30 vjeç në kohën kur fillon programi

#### Çfarë ofron bursa?

- Pjesëmarrësit do të marrin një bursë mujore, e cila aktualisht është 450 €.
- Bursa mbulon shpenzimet për sigurimin shëndetësor apo sigurim në rast aksidenti, si dhe shpenzimet administrative dhe sociale.
- Do të ofrohet edhe akomodim falas, apo nëse dëshirojnë pjesëmarrësit mund të akomodohen diku tjetër. Për këtë ata do të mund të marrin (aktualisht) 250 € në muaj për qira.
- Bursa mbulon gjithashtu edhe shpenzimet e rrugës deri në dhe nga Berlina .

#### Kur është afati i fundit për aplikim?

Afati i fundit për aplikim është 30 qershori i çdo viti. Programi zgjatë çdo vit nga data 1 mars deri më 31 korrik.

#### Informata apo kontakti?

Ambasada Gjermane Prishtinë  
info@pris.diplo.de  
www.pristina.diplo.de

www.bundestag.de/ips



## 3.2 Programi i bursave të Ekonomisë Gjermane për Ballkanin Perëndimor

Bashkë me Ministrinë Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ) Komisioni Lindor i Ekonomisë Gjermane (Ost-Ausschuss der Deutschen Wirtschaft) që nga viti 2004 udhëheq programin e bursave të Ekonomisë Gjermane për Ballkanin Lindor. Në kuadër të këtij programi të diplomuarit dhe studentët e rinjë kryejnë praktika 3-6 mujorsh në një ndërmarrje gjermane.

### **Cilat janë kushtet?**

Praktikantët duhet të kenë një përvojë profesionale në fushën ekonomike ose inxhinierik.

### **Çfarë ofron bursa?**

Ndërmarrjet pjesëmarrëse gjermane kujdesen për kapacitetet menaxhuese, akomodimin dhe vendin e praktikës. Ata marrin përsipër:

- shpenzimet e akomodimit
- shpenzimet e sigurimit shëndetësor

Ministria Federale për Bashkëpunim ekonomik dhe Zhvillim mbështet praktikantët me:

- të holla, në vlerë prej 500,00 € në muaj.

### **Kur është afati i fundit për aplikim?**

Shpallja e konkursit për program bëhet çdo nëntor. Praktikantët fillojnë në verën e vitit vijues.

### **Informatat shtesë apo kontakti i drejtpërdrejtë?**

Informata më të hollësishme mbi këtë program gjeni në: [www.stipendienprogramm.org](http://www.stipendienprogramm.org)



### 3.3 Bursa e Fondacionit Fritz dhe Helga Exner

Fondacioni Fritz dhe Helga Exner ofron bursa pasuniversitare për shkencëtarët e rinj nga Gjermania dhe Evropa Juglindore, të cilët merren me një temë historike apo të historisë bashkëkohore nga kërkimet në fushën e studimeve të Evropës Juglindore.

#### Cilat janë kushtet?

Bursat ofrohen për studentë pasuniversitar, doktorantë dhe të punësuarit në institute kërkimore. Kandidatët nuk duhet të jenë më të vjetër se 40 vjeç.

Kusht është gjithashtu njohja e mjaftueshme aktive ose pasive e gjuhës gjermane.

Dokumentet, të cilat duhet të dorëzohen janë:

- Arsyetim i gjerë, shpjegim i qëllimit që synohet të arrihet, në gjuhën gjermane (gjendja aktuale e kërkimeve, metodologjia, arsyetimi i ekspeditës.)
- Të dhëna të sakta mbi vendin dhe kohën e ekspeditës.
- Mendimi i mentorit apo drejtorit të institutit. Nga shkencëtarët e rinj nga Evropa Juglindore kërkohet të ceken të dhënat e një personi kontaktues nga një universitet gjerman apo nga një institut kërkimor.
- CV me të dhëna mbi studimet e deritanishme, projekteve tanimë të përmbyllura, njohurive të gjuhëve dhe publikimeve (nëse janë bërë).

#### Çfarë ofron bursa?

Bursa mundëson ekspedita (qëndrime kërkimore) të shkurtëra në Evropën Juglindore, gjegjësisht në Gjermani. Bursistët nga vendet e Evropës Juglindore (Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Bullgaria, Republika e Maqedonisë, Greqia, Kosova, Kroacia, Mali i Zi, Moldavia, Rumania, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Turqia, Hungaria, Qipro) marrin një shumë ditore prej 50 € (për më së shumti 28 ditë), e cila mbulon fjetjen. Shpenzimet e udhëtimit nuk merren përsipër nga Fondacioni.

#### Kur është afati i fundit për aplikim?

Përzgjedhja bëhet në një mbledhje të veçantë të mbajtur tri herë në vit (shkurt, qershor, tetor)

Bursa duhet të jetë miratuar para nisjes së udhëtimit ekspeditor, prandaj edhe aplikacionet duhet të dorëzohen deri më së voni në fund të muajve dhjetor, prill apo gusht.

#### Informata apo kontakti?

Për pyetje dhe dorëzim të aplikacioneve kontaktoni zyrën e Shoqatës Evropa Juglindore

Dr. Johanna Deimel

Tel.: +49 / 89 / 21 21 54 - 0

Fax: +49 / 89 / 228 94 69

Email: [info@sogde.org](mailto:info@sogde.org)

### 3.4 Bursa studimi në Gjermani për disciplina të ndryshme sportive

„Kombi i sportistëve“ - Gjermania, ofron kurse të kualifikimit për trajnerë, në mënyrë që të intensifikohen marrëdhëniet ndërkombëtare në këtë fushë. Ministria Federale për Punë të Jashtme e Gjermanisë, në bashkëpunim me Universitetin e Leipzig-it, ofron mundësi studimi në kohëzgjatje prej pesë muajsh në Fakultetin e Shkencave të Edukatës Fizike të Universitetit të Leipzig-it, me ç'rast mësimdhënësit dhe mësimdhënëset e kualifikuar/a të edukatës fizike, ashtu si dhe trajnerët dhe trajneret do të kenë mundësinë për t'i freskuar dhe përsosur njohuritë e tyre në fushën e shkencave të edukatës fizike. Në këtë periudhë kohore në këtë fakultet do të ofrohen kurse në drejtime të ndryshme në gjuhë të ndryshme.

#### **Cilat janë kushtet?**

Diploma për përfundimin e studimeve themelore në degën e edukatës fizike apo kualifikim tjetër adekuat

Përvojë si sportist, mësimdhënës i edukatës fizike apo trajner në llojin përkatës të sportit  
Njohuri të mjaftueshme të gjuhës së huaj, në të cilën do të mbahet kursi

Mosha prej 40 vjet nuk duhet të tejkalohet

Paraqitja e një çertifikate mjekësore, e cila dëshmon aftësitë e përgjithshme dhe të du-rueshme fizike dhe psikike, si dhe mospraninë e sëmundjeve të brendshme, sëmundjeve infektive (përfshirë HIV dhe Hepatitin). Çertifikata nuk duhet të jetë më e vjetër se 2 muaj.

#### **Posaçërisht inkurajohen femrat për pjesëmarrje.**

Për dokumentacionin, i cili duhet t'i bashkangjitet aplikacionit vizitoni faqen e internetit të Universitetit të Leipzigit: [www.itk.uni-leipzig.de](http://www.itk.uni-leipzig.de) ose në atë të Ambasadës Gjermane në Prishtinë: [www.pristina.diplo.de](http://www.pristina.diplo.de)

#### **Çfarë ofron bursa?**

Pjesëmarrësit do të fitojnë bursë mujore. Materialet e kurseve do të jenë në dispozicion në vendin e mbajtjes së kurseve. Shpenzimet e udhëtimit, kthimit, transportit të bagazhit si dhe të të gjitha kontrollave mjekësore dhe pajisjeve sportive duhet të mbulohen nga vetë kandidatët.

#### **Kur është afati i fundit për aplikim?**

Vizito faqen e internetit të Ambasadës Gjermane:  
[www.pristina.diplo.de](http://www.pristina.diplo.de)

#### **Kontakti?**

Aplikacionet me të gjitha dokumentet përkatëse duhet të dorëzohen në këtë adresë:  
Ambasada Gjermane Prishtinë  
A. Jashanica 17, Arbëria II  
10 000 Prishtinë

## 3.5 Bursat Rave për kuratorë, restaurues, teknikë të muzeve dhe menaxherë të kulturës

Fondacioni Rave, nëpërmjet trajnimit praktik dëshiron të kontribuojë në ndërmjetsimin dhe realizimin e ekspozitave në fushën e artit figurativ. Fondacioni Rave ofron bursa për kuratorë, restaurues, teknikë të muzeve dhe për menaxherë kulturor të vendeve në tranzicion dhe vendeve në zhvillim. Atyre do t'ju mundësohet angazhimi, apo punësimi pa pagesë në një institucion gjerman jo-komercial në fushën e arteve të bukura.

### **Cilat janë kushtet?**

#### **Kandidatët duhet:**

- të jenë me prejardhje nga një shtet në tranzicion, ose vend në zhvillim
- të mos kenë pasur deri tani mundësinë e një qëndrimi më të gjatë pune apo trajnimit profesional në Gjermani
- të kenë njohuri të gjuhës gjermane apo angleze (njohuritë elementare të gjuhës gjermane janë kusht)
- të mos jenë më të vjetër se 40 vjeç
- të mos i kenë përfunduar studimet para më shumë se 5 viteve
- të mos jenë më në studime apo në zanat në kohën kur aplikojnë
- të kenë fletpranimin e një institucioni partner jo-komercial në Gjermani, i cili dëshmon një përkujdesje ose një projekt të përbashkët pune
- të kenë një fletrekomandim nga shteti i tyre
- të mos kenë aplikuar ndonjëherë më parë. Ata, të cilët kanë aplikuar njëherë humbin të drejtën për të aplikuar përsëri!

### **Çfarë ofron bursa?**

- Një shumë mesatare mujore në vlerë prej 1.300 euro për një qëndrim prej 3 deri në 6 muaj
- Shpenzimet e udhëtimit (shkuarja dhe kthimi)
- Shtesa për të martuarit (nëse edhe bashkëshorti/-ja ndodhet në Gjermani)
- Shtesa për sigurim shëndetësor (edhe për bashkëshortin/en dhe fëmijet)
- Shpenzimet për kurs të gjuhës gjermane (vijimi i të cilit është kusht)

### **Kur është afati i fundit për aplikim?**

Afati i fundit për aplikim është 15 shtatori i çdo viti. Rezultati kumtohet 3 muaj pas dorëzimit të aplikacionit. Aplikacionet mund të dërgohen me postë ose në mënyre elektronike. Fletrekomandimi si dhe dëshmia e pranimit nga një institucion gjerman duhet të dërgohen doemos në origjinal me postë.

### **Kontakti?**

Rave-Stiftung  
c/o Institut für Auslandsbeziehungen  
Charlottenplatz 17  
D-70173 Stuttgart  
rave-stiftung@ifa.de

## 4. Mundësi për mësimdhënës të gjuhës gjermane



## 4.1 Seminare në Gjermani për mësimdhënës të gjuhës gjermane në shkollat fillore dhe të mesme/gjmnaze apo në arsim të të rriturve, si dhe për trajnuesit e mësimdhënësve të gjuhës gjermane.

Instituti Goethe si institucion kulturor i Republikës Federale të Gjermanisë, i cili vepron në tërë botën ka për qëllim përkrahjen e njohurive të gjuhës gjermane në botën e jashtme, përkujdesen për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e kulturës dhe transmetimin e një imazhi gjithpërfshirës për përshlyetje sa më të tërësishme për Gjermaninë. Në kohërat e sfidave të reja globale, qëllimi i punës së Institutit Goethe është një mirëkuptim më i thellë në mes të kulturave si dhe forcimi i reputacionit të Gjermanisë në botë. I themeluar në vitin 1951, Instituti Goethe përbëhet nga më shumë se 136 institucione, 11 zyra ndërlidhëse në 93 vende si dhe 13 institute në Gjermani. Instituti Goethe gjithashtu mbikqyrë edhe salla të shumta të leximit, shoqata kulturore si dhe qendra të materialeve mësimore në tërë botën.

### Bursat

Me një zgjedhje të larmishme të seminareve dhe materialeve për mësimdhënësit dhe multiplikatorët në sistemin arsimor, ne bashkë me partnerët lokalë nxisim cilësinë e mëimit të gjuhës gjermane. Nëpërmjet programeve të bashkëpunimit arsimor gjerman ne kemi arritur tek më shumë se gjashtë milionë njerëz. Çdo vit rreth 1700 mësimdhënës të gjuhës gjermane marrin bursa për t'u trajnuar në Gjermani.

### Cilat janë kushtet?

- Përgatitja profesionale e përfunduar
- Njohuri të gjuhës gjermane (dallon në varësi të seminarit)
- Të mos jeni më i vjetër se 55 vjeç
- Gatishmëria që të ndani njohuritë e fituara gjatë seminarit me kolegët tuaj pas kthimit nga trajnimi

### Çfarë ofron bursa?

- Mbulimin e të gjitha shpenzimeve të orëve mësimore, si dhe shpenzimeve për ekskurzionet dhe vizitat e ngjarjeve kulturore, të planifikuara me programin e seminarit
- Akomodimin (dhomë njëshe apo dyshe) me mëngjes për kohëzgjatjen e seminarit
- Një shujtë kryesore në ditët e seminarit (por jo të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare)
- Pagesë shtesë
- Sigurimim shëndetësor, sigurim në rast aksidenti, si dhe sigurim të përgjegjësisë gjatë kohës së seminarit, duke përfshirë ditët e udhëtimit dhe kthimin për arsye mjekësore
- Kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në vlerë prej 350 euro (i cili paguhet në vendin ku mbahet seminari)

### Kur është afati i fundit për aplikim?

Për këtë si dhe informata të tjera vizito këto faqe të internetit:

Instituti Goethe në Gjermani: <http://www.goethe.de>

Seminaret në Gjermani: <http://www.goethe.de/lhr/prj/fid/deindex.htm>

Kushtet për të aplikuar për një bursë të Institutit Goethe, si dhe procedura e aplikimit: <http://www.goethe.de/lhr/prj/fid/abw/gii/deindex.htm>



## Bursa për kurse të gjuhës gjermane për partnerët e fushave të ndryshme të Institutit Goethe

### Cilat janë kushtet?

- Përgatitja profesionale e përfunduar
- Njohuri paraprake të gjuhës gjermane (së paku niveli A1)
- Bashkëpunim i ngushtë me institucione kulturore gjermane apo me Gjermaninë

### Çfarë ofron bursa?

- Orë mësimore
- Akomodimin në dhomë teke
- Mengjesin dhe drekën
- Shtesa për shpenzime
- Sigurimin shëndetësor
- Kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit prej 350 € (i cili paguhet në vendin ku mbahet seminari)

### Kur është afati i fundit për aplikim?

Këto si dhe informata të tjera mbi kurset e gjuhës të Institutit Goethe në Gjermani ju mund t'i gjeni në faqen e internetit:

- për të rritur: <http://www.goethe.de/ins/de/deindex.htm>
- për fëmijë dhe të rinj: <http://www.goethe.de/ins/de/spr/kuj/kur/deindex.htm>

### Kontakti?

Goethe-Institut Belgrad  
Knez Mihailova 50  
11000 Belgrad  
Tel.: +381 11 26 22 823  
<http://www.goethe.de/belgrad>

Më shumë informata?  
<http://www.goethe.de/belgrad>

---

**Botues:** Ambasada Gjermane Prishtinë  
Seksioni për Kulturë  
Azem Jashanica 17, Arbëria II  
10000 Prishtinë

**Perkthimi:** Samira Ajzeri  
Ramize Ferati

**Publikuar në:** Prishtinë, maj 2012

**Shtypi:** ASHA  
**Tirazhi:** 300

*Kjo broshurë përmban vetëm një përzgjedhje të mundësive të bursave, informatat për të cilat nuk janë të plota.*

*Kjo broshurë është përgatitur edhe në gjuhën serbe.*



[www.pristina.diplo.de/bursat](http://www.pristina.diplo.de/bursat)